

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-085/2015

Prishtinë,
14 Dhjetor 2016

Në çështjen juridike të:

N. V.

Pala ankuese

kundër.

Č. Š.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPPC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA17863), të datës 13 mars 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 Dhjetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e N. V. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me Nr. KPA17863.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014 sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me Nr. KPA17863.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 23 janar 2007, Č.Š, duke vepruar si anëtar bashkësisë familjare të nënës së tij I. Š. (tutje: Pala përgjegjëse në ankesë) ka parashtruar një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin fillimisht mbi ngastrën nr. 35, 239, 269 dhe 21, në sipërfaqe prej 09.01.70 ha gjithsejtë, që gjendet në fshatin Petroviq në Komunën e Shtimës. Rrjedhimisht kërkesa fillestare është ndarë për shkak se ngastrat nuk ndodheshin ngjitur me njëra tjetrën. Kërkesës fillestare KPA17863 pas ndarjes përmban vetëm ngastrën nr. 35 (tutje: prona e pretenduar).
2. Pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se ëma e tij I. Š., e cila ka vdekur në vitin 1978, ka qenë pronare e pronës së pretenduar dhe se posedimi i po kësaj prona ka humbur si rrjedhojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998-1999, duke e theksuar 12 qershorin e vitit 1999 si datë të humbjes.
3. Pala përgjegjëse në ankesë në mbështetje të kërkesës së tij i ka siguruar AKP-së dokumentet e mëposhtme:
 - Padinë Nr. 36/90, të datës 9 korrik 1999, të paraqitur në Gjykatën Komunale në Ferizaj nga Prokurori Publik i Ferizajit kundër KBI “Milan Zecar”, Pala përgjegjëse në ankesë dhe vëllezërve të tij L. dhe V. Š, me qëllim të anulimit të Kontratës së shitjes nr. 872/64, të datës 29 shtator 1964, dhe kontratën e shitjes nr. 494/63 të datës 11 qershor 1963, kontrata këto që janë lidhur për blerjen e pronës së pretenduar nga KBI “Milan Zecar” prej bartësit të së drejtës pronësor- nënës së Palës Ankuese I. Š.
 - Deklaratat e shkruara të Pala përgjegjëse në ankesë të datës 31 mars 2008 dhe 6 gusht 2009. Pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se prona e pretenduar ka qenë në posedim të Kooperativës së Shtimjës megjithatë, deri në vitin 1990, kooperativa tashme e kishte shitur atë. Përkundër se Pala përgjegjëse në ankesë e posedon Aktgjykimin që vendos për kthimin e pronës së pretenduar atij dhe vëllezërve të tij pas vdekjes së nënës tyre, po i njëjti

aktgjykim nuk është zbatuar kurrë për shkak të bartjes të së drejtës pronësore tek palët e treta.

- Certifikatën e lindjes nr. 60, të lëshuar me 4 mars 2009 nga Zyra e Regjistrimit Civil në Komunën e Nikshiqit në Mal të Zi, që provon se I. Č.ka qenë nëna e Palës përgjegjëse në ankesë.
 - Dokumente të tjera që nuk kanë të bëjnë me pronën e pretenduar apo janë të parëndësishme për vendimmarrje.
4. Njoftimi fillestar rreth pronës së pretenduar është bërë me 9 dhjetor 2008 me gjetjen se prona nuk ishte e uzurpuar. Njoftimi fillestar për pronën e pretenduar është konsideruar si jo korrekt, prandaj njoftimi i dytë është bërë me 1 korrik 2010. Njoftimi është bërë me publikim në Gazetën e Njoftimeve Nr. 3. Gazeta si dhe Lista iu lanë udhëheqësit të fshatit i cili pranoi që do të i vinte në dispozicion të palëve të interesuara, ashtu sikurse edhe në hyrje dhe dalje të Komunës së Pejës. Po të njëjtat publikime po ashtu iu lanë Avokatit Publik të Komunës, Zyrës Kadastrale, Gjykatës Komunale, Zyrës rajonale të APK-së në Pejë, sikurse edhe në DRC, OSBE, UNHCR, Agjencinë Kosovare të Privatizimit, EULEX dhe Avokatin e Popullit.
 5. N.V. (tutje: Pala ankuese) me 9 tetor 2012 iu është afruar Sekretariatit Ekzekutivë të AKP-së duke parashtruar deklaratën me shkrim me të cilën ka deklaruar se ai e kishte blerë pronën e pretenduar prej V. I. Š. gjatë vitit 1964. Në po të njëjtin vit çmimi i shit-blerjes është pranuar prej shitësit dhe që nga ajo koha ai ka qenë në shfrytëzim të pa penguar e të vazhdueshëm të pronës. Pala ankuese në ankesë ka theksuar si ai nuk posedon ndonjë provë që e dëshmon deklaratën e tij ngase të gjitha dokumentet në posedim të tij ishin djegur gjatë konfliktit, mirëpo ai ka propozuar emrat e dëshmitarëve që mund të dëshmojnë nëse AKP-ja vendos që ta mbajë seancën dëgjimore.
 6. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së ex officio ka siguruar një aktgjykim të pjesshëm C. Nr. 438/90, të datës 18 shkurt 1991 i lëshuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj, i cili e shpallë kontratën e lartcekur të shitblerjes si nule dhe të pavlefshme ndërsa Vendimi për Kthimin e pronës së pretenduar ka mbetur për një Aktgjykim pasues ngase prona e pretenduar është bartur tek palë të treta pas lidhjes së Kontratës së shitblerjes. Prona e pretenduar është e regjistruar në emër të kooperativës bujqësore.
 7. KKKP-ja me vendimin KPCC/D/A/228/2014, të datës 13 mars 2014, e ka hedhur poshtë kërkesën në mungesë të Kompetencës. KKKP-ja ka vërtetuar se lënda nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur të vitit 1998-1999.
 8. Pala ankuese e ka pranuar këtë vendim me 1 shtator 2014. Ai ka paraqitur Ankesë me 13 tetor 2014.

9. Vendimi iu është dorëzuar Palës përgjegjëse në ankesë me 13 nëntor 2014, por ai e ka refuzuar atë.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese pretendon KKPK-ja ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
11. Ai pretendon se Pala përgjegjëse në ankesë ia ka shitur pronën e pretenduar babait të tij në vitin 1964. Sipas palës ankuese bartja e të drejtës pronësore në emrin e babait të tij nuk është kryer ngase prona ka qenë në emër të nënës së Palës Ankuese, së pari ai është dashtë ta transferoj atë në emrin e tij me qëllim që serish ta transferoj në emrin e babait të Pala ankuese si dhe për shkak të taksave që ai është dashtë të i paguaj për bartjen e patundshmërisë.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

12. Gjykata Supreme ka shqyrtuar vendimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore nr. 03/L-006 (tutje: LKP) dhe pas vlerësimit të deklaratave të ankesës ka gjetur se Ankesa është e pranueshme ngase është parashtruar brenda afatit ligjor nga Ligji nr. 03/L-079, që përcakton se pala mund të paraqes ankesë kundër Vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve prej ditës që palët janë njoftuar për vendimin.

Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme e Kosovës e ka shqyrtuar ankesën në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LKP-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa është e pathemeltë.
14. KKPK-ja e ka mbështetur vendimit e vet në faktin se Parashtruesja e Kërkesës nuk ka arritur që të demonstroj se kërkesa e saj lidhet me rrethana që drejtpërdrejt kanë të bëjnë ose pasojnë prej konfliktit të vitit 1998-1999.
15. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë e një urdhri prej Komisionit për riposedim të pronës nëse Paraqitësi i kërkesës jo vetëm se e dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private por po ashtu nëse ai apo ajo nuk ka është në gjendje të ushtroj të drejta të tilla pronësore për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti janë të ndërlydhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

16. Nga faktet e vërtetuara dilet në përfundim se kontesti për pronën në fjalë nuk ka të bëjë me konfliktin e armatosur të 1998-1999. Kontesti i referohet prapa vitit 1963 kur prona e familjes së Palës përgjegjëse në ankesë është shpronësuar dhe marrë nga KBI “Milan Zečar”. Ky fakt e vërteton pala përgjegjëse në ankesën e tij dhe kërkesën. Familja e palës përgjegjëse në ankesë e ka humbur posedimin e tokës shumë kohë para konfliktit të armatosur. Prej gjetjeve të Komisionit ashtu edhe të Gjykatës Supreme për Kthimin e pronës së pretenduar tek Pala përgjegjëse në ankesë apo tek anëtarët e familjes së tij nuk është bërë për shkak të shitjes së pronës së pretenduar tek palë të treta. Toka e pretenduar tani është e regjistruar në emrin e Kooperativës Bujqësore.
17. Në anën tjetër Pala ankuese nuk ka mund ta dëshmojë të drejtën e pronësisë në pronën e pretenduar. Përveç deklaratës me shkrim nuk ka paraqitur ndonjë provë për ta provuar pretendimin e tij.
18. Prandaj, në pah të arsytimit dhe në pajtim me dispozitat e nenit 13.3, pika C, të Ligjit nr. 03/L-079, vendoset si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këshillë juridike:

19. Sipas nenit 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit,

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it